

VENDIM
Nr. 153, datë 30.9.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR
EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO), VERSIONI 1.4**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2016, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionarë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO) dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO) versioni 1.4.

konstatoi se:

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (Vjenë, Austri), me shkresën e datës 13.9.2016 dhe mbledhja e 11-të e ECBR-së, mbajtur në datën 9.7.2009, rekomandojnë që rregullatorët kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore.

- OST sh.a., me shkresën nr. 4855 prot., datë 25.8.2016, ka përcjellë për miratim në ERE draftin e “Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO) versioni 1.4.

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft “Rregullat e ankandit, versionin 1.4”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti